



Komisioni i Pavarur i Kualifikimit




Raport Statistikor **Shtator 2019 – Dhjetor 2019**

Komisioni i Pavarur i Kualikimit nga muaji shtator 2019 deri në muajin dhjetor 2019 ka dhënë 32 vendime.


- **13** vendime për konfirmimin në detyrë të 6 gjyqtarëve, 6 prokurorëve dhe 1 ndihmës ligjor;
- **15** vendime për shkarkimin nga detyra të 10 gjyqtarëve dhe 5 prokurorëve;
- **4** vendime për ndërprerjen e procesit të 3 gjyqtarëve dhe 1 prokurori.

Këto vendime pasqyrohen në grafikët e mëposhtëm.


Grafik 1: Vendimet e KPK-së, shtator 2019 – dhjetor 2019




Grafik 2: Konfirmimet në detyrë në bazë të funksionit të subjektit të rivlerësimit



Grafik 3: Shkarkimet nga detyra në bazë të funksionit të subjektit të rivlerësimit




Grafik 4: Ndërprerjet e procesit në bazë të nenit G të Aneksit të Kushtetutës




Komisioni i Pavarur i Kualifikimit ka dhënë **29** vendime me unanimitet dhe **3** vendime me shumicë votash.

Grafik 5: Vendime me unanimitet dhe shumicë votash



Komisioni i Pavarur i Kualifikimit ka dhënë **7** vendime bazuar në një kriter, **0** vendime bazuar në dy kritere dhe **21** bazuar në të trija kriteret e rivlerësimit.

Grafik 6: Numri i vendimeve sipas kritereve të rivlerësimit




Pavarur i
Kualifikimit

Organet ndihmëse të Komisionit në këtë proces janë Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI) për vlerësimin e pasurisë dhe Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) për vlerësimin e figurës. Vendimmarrja e Komisionit nuk është e kushtëzuar nga përfundimet e rezultateve të këtyre raporteve, pasi Kushtetuta i njuh KPK-së të drejtën e një hetimi të pavarur.

Sipas raporteve të ILDKPKI-së për **28** subjekte rivlerësimi, kanë rezultuar pa probleme me pasurinë **17** subjekte rivlerësimi dhe me probleme **11** prej tyre, ndërkohë që hetimi i kryer nga Komisioni ka dhënë rezultate të tjera: kanë rezultuar **13** subjekte pa probleme me pasurinë dhe **15** subjekte me probleme.

Grafik 7: Raporti i ILDKPKI-së dhe rivlerësimi i KPK-së



Nga raportet e DSIK-së për 21 subjekte rivlerësimi, kanë rezultuar të papërshtatshëm për vijimin e detyrës 5 subjekte rivlerësimi, ndërkohë që nga hetimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit rezultoi me probleme 1 subjekt rivlerësimi.

Grafik 8: Raporti i DSIK-së dhe kontrolli i figurës i KPK-së

